



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
REKTORATI

Nr. 20/4/3 Prot.

Vlorë, më, 11.12.2020

VENDIM

Nr. 28, datë 09. 12. 2020

PËR

**“ VEPRIMTARINË DHE NGARKESËN MËSIMORE VJETORE TË PERSONELIT
AKADEMIK PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021”.**

Në mbështetje të ligjit Nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, të Statutit dhe Rregullores së Universitetit ‘Ismail Qemali’ Vlorë, Udhëzimit Nr. 5, datë 19.02.2018, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “ Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor”, me qëllim planifikimin e ngarkesës mësimore vjetore të personelit akademik dhe përfshirjen e saj në buxhetin e vitit 2021, në mbledhjen e zhvilluar në datën 09.12.2020, Rektorati

VENDOSI

1. Përcjelljen e ngarkesës mësimore të planifikuar në auditor, për personelin akademik me kohë të plotë, për personelin akademik të ftuar, për personelin me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2020-2021.
2. Përcjelljen e mbingarkesës vjetore në auditor për personelin akademik me kohë të plotë, për vitin akademik 2020-2021. Për rastet kur mbingarkesa e personelit akademik tejkalon mbingarkesën në auditor mbi 200 orë, të argumentohen për secilin rast kushtet specifike referuar udhëzimit nr.29 datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore vjetore për personelin akademik në institucionet e arsimit të lartë” të MASR.
3. Përcjelljen e parashikimit dhe raportimin e ngarkesës “ Jashtë auditorit”, referuar udhëzimit Nr.29 datë 10.09.2018 “ Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore vjetore për personelin akademik në institucionet e arsimit të lartë” të MASR si edhe listën e personelit akademik i cili do të angazhohet në veprimtari të pagueshme jashtë auditorit, si udhëheqje teze /diploma në ciklet I, II, III, dhe praktika në terren e praktika profesionale.
4. Përcjelljen e ndarjes së grupimeve mësimore (leksione, seminare, laboratore, praktika) për çdo program studimi, bazuar në tabelën Nr.2 të VKM nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi fakultetet, departamentet e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, Zv/Rektori akademik për përcjelljen e pasqyrës përfundimtare drejtuar administratores së Universitetit, me qëllim përfshirjen e mbingarkesës së planifikuar, në buxhetin e vitit 2021.(Tabela bashkëlidhur).

Afati i dorëzimit të këtij dokumentacioni 18 dhjetor 2020.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof.Dr.Roland ZISI

PASQYRE PERMBLEDHESE PER MBINGARKESEN E PAGUESHME TE PLANIFIKUAR 2020-2021

Bazuar ne udhezimin e MASR, nr.29 date 10.08.2018.

Nr	Emër	Mbiemër	Titulli/ grada	Pozicioni	Ngarkesa mesimore/ auditor	Totali Ore suplementare/ ne auditor	Ore suplementare jashte auditorit (te pagueshme)			Totali Ore suplementare/ jashte auditor	Total Ngarkesa mesimore (brenda dhe jashte auditorit)	Firma
							Udhëheqje teze diplome	Drejtim i Praktikave Mësimore				
1												
2												
3												
4												
5												
6												
Total												

Pergjegjesi i Departamentit

Dekani